

VENDIM
Nr. 676, datë 28.9.2016

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA TIRANË,
PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE PËRBËRËSE FARKË, TIRANË, TË TRUALLIT
FUNKSIONAL, ME SIPËRFAQE 2 187 m², BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 186,
ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR. 3042, QENDËR STËRVITORE”, ME
VENDNDODHJE NË SAUK, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.
515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë, për Njësinë Administrative Përbërëse Farkë, Tiranë, të sipërfaqes truall funksional (S3), prej 2 187 (dymijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë) m², nga trualli funksional i pronës nr. 186, me emërtim “Reparti Ushtarak nr. 3042, Qendër Stërvitore”, në Sauk, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për nevoja urbanistike, për ndërtimin e rrugës publike “Stërmas – Picallë – Reparti Ushtarak – Sauk – Garunjë – TEG”.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet sipërfaqja truall, prej 2 187 (dymijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë) m², nga trualli funksional i pronës nr. 186, me emërtim “Reparti Ushtarak nr. 3042, Qendër Stërvitore”, Sauk, Tiranë, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Njësisë Administrative Përbërëse Farkë, të Bashkisë Tiranë.

3. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të sipërfaqes truall, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Para fillimit të punimeve, Bashkia Tiranë të ndërtojë rrethimin në kufijtë e rinj të pronës, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e rrugës, sipas parametrave dhe kushteve teknike, duke i kthyer ato në gjendjen e tyre të mëparshme. Për këtë qëllim, të hartohet një aktmarrëveshje e përbashkët ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Komandës së Forcës Ajrore Rinas, Tiranë.

5. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Tiranë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Planvendosje e rep.usht. nr.3042, Qendër Stërvitore (Prona 186)
Sipërfaqja që zë projekti i rrugës

SISTEMI I KOORDINATAVE SHETETERORE

574
200

574
100

573
850

MIRATOHET
Komandanti i Forcës Ajrore
Gjeneral Brigade Vladimir **AVDIAJ**

Në emërtim të Urdhrit
Kolonel Mehmet Dello



Shpjeguese :

 Sip.S3 që zë projekti i rrugës = 2 187.00 m²

S3

573
850

S3

Shënim: Kjo planvendosje u hartua bazuar në planvendosjen e marrë në arkivin e IGJIIU-së (hartuar në Janar 2016), si dhe në bazë të shkresës së KPA-së me nr.824/1, datë 26.02.2016.

4
573
600
400

HARTOI
Topograf Ramiz HAXHIU

SHKALLA 1:2500

Ripunuar Mars 2016

DREJTORI I IGJIIU
N/Kolonel Zydi **ALCANI**



